

PJESA ORGANIKE (aty ku parashikohet)



ÇFARË

Mbeturinat e gatimit dhe mbetjet ushqimore, mbeturinat e zarvateve dhe frutave, lulet e prera dhe lulet e shtëpisë, buka e ndenjtur, mbetjet e kafesë ekspres dhe filtrat e çajit, letrat thithëse të kuzhinës, ushqimet e prishura, lëvozhgat e vezëve, rerën prej materiali organik për kafshët shtëpiake.

ÇFARË NUK DUHET TË VË?

Të gjitha plehurat e tjerë që mund mblidhen veç (letra, plastika, qelqi, etj.).

KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?

Vendosi materialet në koshin ngjyrë KAFE që gjendet në rrugë.



MBETURINA TË MËDHA E MAEE

(Mbetje nga Aparatet Elektrike dhe Elektronike)

ÇFARË: kolltuqet, divanet, dyshekët e susta, mobiljet, frigoriferët, kompjuterat, televizorët, printerat etj.

KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?

Dorëzoi tek ishulli ekologjik i caktuar ose telefono në numrin e gjelbër 800.36.55.52



KOMPOSTIMI NË SHTËPI

Kush ka një oborr apo një kopsht mund t'i kompostojë mbeturinat nga gatimi dhe nga kopshti drejtpërsëdrejti në shtëpinë e vetë, duke i kthyer në tokë për bimët.

ÇFARË MUND TË PËRZIHET

Mbeturinat e frutave dhe zarvateve, mbeturinat vegjetale nga gatimi, lulet e prera, buka e ndenjtur e mykur, lëvozhgat e vezëve, kafeja e përdorur, filtrat e çajit, shamitë prej letre, letra thithëse që përdoret në kuzhinë, gjethet, kashtën, tallashin, barin e kositur (më mirë nëse janë të prera hollë), etj.

ÇFARË S'MUND TË KOMPOSTOHET

Kockat me përmasa të mëdha, guackat e molusqeve (të midhjeve, të frutave të tjera deti)

SI BËHET

Përgatit një drenazh me material mbajtës (degëza, bujashka, etj.). Përziej mbeturinat nga kuzhina me mbeturinat nga kopshti. Duhet garantuar prania e oksigjenit duke përdorur materiale që japin porozitet; nganjëherë, është mirë ta përziesh materialin. Për të garantuar nivelin optimal të lagështisë, drenojë, vendose në hije ose ujite përzierjen.



CILAT SISTEME

Grumbullimi ose gropa (plehërishte ose gropë plehu) janë metodat më efektive për një ajrim më të mirë dhe për ta bërë më të lehtë përzierjen e materjalit. Këto sisteme janë të përshtatshme për ata që kanë një oborr ose kopsht të madh. Komposter-i është një kosh i ajrosur, i studiuar posaçërisht për ta bërë kompostimin në hapësira të gjelbra të vogla. Ka disa zgjidhje: duke filluar nga më ekonomiket të ndërtuara vetë (në rrjet metalik të veshur) deri tek komposter-i i mbyllur prej plastike.

CONSORZIO
S E A

Aimeri Ambiente



NUMRI GJELBËR: 800.36.55.52
info@consorziosea.it
www.consorziosea.it

Territori ynë është PËRGJITHMONË



Për mbrojtjen e mjedisit dhe vlerësimin sa më të drejtë të burimeve natyrore, Administrata bashkiake, Koncerni SEA dhe Shoqëria Aimeri kanë projektuar një shërbim të ri për grumbullimin e plehrave. Me angazhimin e të gjithëve do t'ia dalim t'i arrijmë këta objektiva të rëndësishëm.

Çdo ditë një
grumbullim të
ndryshëm



Na ndihmo ta ruajmë. Bëj grumbullimin e veçuar.

LETRA DHE KARTONI



ÇFARË MUND TË NDAJ MËNJANË?

Të gjitha paketimet në karton të përdredhur të çdo forme a madhësie, kutitë prej kartoni të frutave e perimeve. Gazetat, revistat, librat me karikatura ose me vizatime, broshurat, fletushkat e reklamave, qeset prej letre për ushqimet, bukën apo frutat, qeset prej letre me doreza, fletët e letrës të çdo lloji a përmase, kutitë e qumështit dhe të lëngjeve të frutave (lloji Tetra Pak®), të gjitha kutitë dhe paketimet prej kartoni. Kutitë prej letre të prodhimeve ushqimore (kutitë e makaronave, të orizit, etj), mbështjellëset prej kartoni të prodhimeve si konservat, kos dhe pije, kutitë e këpucëve, kutitë e detergjentëve apo produkteve për larje (nëse janë të pastra), kutitë e pastave të dhëmbëve, etj.

ÇFARË NUK DUHET TË VË?

Letrat e pista, letrat me yndyrë, letrat për pjekje në furrë, letrat e plastifikuara, letër kopjativ, letrat që mbështjellin sallamrat e djathrat.

KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?

Shërbimi derë më derë: mblidh materialin në kutinë e BARDHË për letrat dhe vendose atë përpara shtëpisë tënde në ditët dhe orët e caktuara.

Shërbimi rrugor:

Vendos materialet në koshin E BARDHË.



QELQI



ÇFARË MUND TË NDAJ MËNJANË?

Kutitë, shishet dhe gotat, vazot e vogla dhe të mëdha, flakonet dhe kavanozat (bosh).

ÇFARË NUK DUHET TË VË?

Tavat prej xhami për pjekje në furrë, objektet prej kristali, qeramikat, porcelanat, llambat, neonet.

KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?

Përdor koshin përkatës në rrugë ngjyrë JESHILE.

PAKETIMET PLASTIKE



ÇFARË MUND TË NDAJ MËNJANË?

Shishet e ujit e të lëngjeve të shtypura dhe mbyllura me tapë, flakonet e pluhurave larës, të shampove, kutitë e lëngjeve, kutitë e ushqimeve, mbajtëset plastike të kosit, çantat dhe qeset prej plastike, kutitë për perime dhe fruta, rrjetat për frutat e në përgjithësi çdo paketim prej plastike e polistiroli.

ÇFARË NUK DUHET TË VË?

Pjata, lugë, pirunjt, thika e gota plastike, lodra të prishura, objekte prej plastike të fortë, polistiroli për ndërtim, zarfat për dokumenta e në përgjithësi çdo gjë që nuk konsiderohet paketim.

KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?

Shërbimi derë më derë: mblidh materialin në qesen e VERDHË gjysmë-transparente dhe vendose atë përpara shtëpisë tënde në ditët dhe orët e caktuara.

Shërbimi rrugor:

Vendos materialet në koshin e VERDHË.



MBETJET URBANE TË PADALLUESHME



ÇFARË

Pjatat, lugët, pirunjt, thikat dhe gotat prej plastike, lodrat, gomtat, pecetat thithëse, cd-romët dhe kutitë e tyre, plaçkat e vjetra, copëzat e qeramikes e të porcelanës, letrat e pista, letrat që mbështjellin sallamrat e djathrat.

ÇFARË NUK DUHET TË VË?

Të gjitha plehrat e tjera që mund mblidhen veç (letra, plastika, qelqi, etj.).

KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?

Shërbimi derë më derë: mblidh materialin në qesen GRI gjysmë-transparente dhe vendose atë përpara shtëpisë tënde në ditët dhe orët e caktuara.

Shërbimi rrugor:

Vendos materialet në kutinë E GJELBËR

ISHULLI EKOLOGJIK



Është një vend i ruajtur ku mund të sillen të gjitha ato mbeturina që s'mund të recuperohen apo që mund të jenë të rrezikshme për mjedisin, duke iu përmbajtur dispozitave të punonjësit të ngarkuar. Mund të dorëzohen në ishull mbeturinat që vijojnë: letra, kartoni, jeshillëqet (pjesët e prera), qelqi (edhe pllakat, damixhanat) paketimet prej plastike, metalet, druri, mbeturinat me përmasa të mëdha, të mirat materiale, frigoriferët, rrotat e makinave, vajrat minerales të përdorura dhe vajrat e kuzhinës të përdorura, inertet (sasi të vogla gërmadhash nga punime të kryera vetë, sanitare, pllaka), bojrat, bateritë e mbaruara, baterite prej plumbi që vijnë nga vetëmirembajtja e automjetit, ilaçet e skaduara, kontejnerat bosh të bojrave për printer (toner) Ku janë: për të njohur vendosjen e ishullit ekologjik bashkimi ku mund të dorëzosh këtë lloj mbeturinash, konsulto sitin eeb www.consorziousea.it. Aty do të gjejsh listën e bashkive, së bashku me ishullin ekologjik përkatës dhe ditët e orët e hapjes.



PILAT, BATERITË DHE ILAÇET E PËRDORURA

ÇFARË: Pilat stilo dhe të rumbullakta për ora, bateritë për aparate elektroshtëpiake të vogla, blisterat, flaconet për shurup, shiringat e mbyllura me tapë, ilaçet e skaduara. **KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?** Përdor koshat përkatës në rrugë ose dorëzoji tek ishulli ekologjik

PLAÇKAT E PËRDORURA/VESHJET

ÇFARË: çdo veshje por vetëm në rast se është e pastruar e në gjendje jo të keqe, këpucë, çanta, kapele, bluza, pantallona, etj. **KU MUND TA VENDOS MATERIALIN E VËNË MËNJANË?** Përdor koshat përkatës në rrugë ose dorëzoji tek ishulli ekologjik